Ky vendim është themelor për kuptimin e dinamikës së SLAPP: Gjykata thekson qartë se **korporatat e mëdha nuk duhet ta përdorin sistemin ligjor për të frikësuar individët** me kosto të larta dhe procese të gjata gjyqësore. Përmes këtij rasti, Gjykata në mënyrë indirekte njezh thelbin e SLAPP – përdorimin e padive jo për mbrojtje të reputacionit, por për heshtjen e kritikës me interes publik. Kështu, rasti McLibel është bërë një precedent që citohet shpesh në kontekstin e debatit evropian për mekanizmat anti-SLAPP.

⁴ <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-68224%22%5D%7D>

Elementet SLAPP në rast

Elementi	Përshkrimi
Qëllimi i padisë	Heshtja e aktivistëve që kritikojnë praktikën afariste të McDonald's përmes një procesi gjyqësor të gjatë dhe të kushtueshëm.
Presion institucional	Sistemi lejoi që një korporatë me burime të mëdha të padiste dy qytetarë pa qasje në ndihmë juridike falas.
Mungesë e barazisë	Aktivistët nuk kishin avokatë, ndërsa McDonald's kishte një ekip të tërë juristësh – shkelje e të drejtës për proces të drejtë dhe e parimit të “barazisë së armëve”.
Efekt frikësues	Procesi gjyqësor zgjati mbi 10 vjet, me qëllim të dekurajimit të kritikëve dhe aktivistëve të tjerë.
Sfond politik/shoqëror	Lidhur me lirinë e shprehjes, mbrojtjen e mjedisit, të drejtat e punëtorëve dhe përgjegjësinë korporative – tema me interes publik.

2. Otegi Mondragon v. Spain (2011)⁵

Otegi Mondragon, politikan bask, u dënua me burg për fyerje të mbretit të Spanjës në kontekst të një fjalimi politik. GJEDNJ konstatoi **shkelje të nenit 10 të Konventës**, duke theksuar **se fjalimi politik dhe kritika ndaj figurave publike gëzojnë nivelin më të lartë të mbrojtjes** në një shoqëri demokratike. Gjykata vuri në dukje se sanksionimi i deklaratave të ashpra, por legjitime politike, përbën ndërhyrje të tepruar të shtetit në lirinë e shprehjes.

Ky rast është i rëndësishëm në kontekstin e SLAPP sepse tregon se si **institucionet dhe zyrtarët shtetërorë mund ta keqpërdorin sistemin ligjor për të shtypur fjalën politike kritike**. GJEDNJ bëri një dallim të qartë midis shprehjeve të urrejtjes dhe kritikës politike, duke përfunduar se edhe fjalimi provokues ose ofendues mund të mbrohet nëse kontribuon në debatin publik. Vendimi përfaqëson një bazë të fortë juridike kundër padive publike të drejtuara ndaj aktivistëve, gazetarëve dhe kundërshtarëve politikë – viktima tipike të procedurave SLAPP.

Elementet SLAPP në rast

Elementi	Përshkrimi
Qëllimi i padisë	Heshtja e një aktivisti politik për shkak të kritikës ndaj organeve gjyqësore dhe politikës shtetërore.
Presion institucional	Shteti përdor sistemin penal për të sanksionuar fjalën e një politikani opozitar.
Mungesë e provave konkrete	Dënimi bazohet në një fjalim politik, pa asnjë nxitje ndaj dhunës apo urrejtjes.
Efekt frikësues	Ndëshkimi i fjalës (në këtë rast me burgim) ka potencial të dekurajojë persona të tjerë – veçanërisht politikanë, gazetarë dhe aktivistë – nga shprehja e qëndrimeve kritike për shkak të frikës nga pasojat ligjore.
Sfond politik	Lidhur me çështjen baske, pavarësinë dhe tensionin politik ndërmjet shtetit spanjoll dhe lëvizjeve rajonale.

⁵ Shih [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-103951%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-103951%22]})

3. Şahin Alpay v. Turkey (2018)⁶

Në këtë rast, gazetari dhe profesori universitar Şahin Alpay u arrestua dhe u mbajt në paraburgim pas përpjekjes së dështuar për grusht shteti në Turqi në vitin 2016. Autoritetet e akuzuan se përmes kolumnave dhe paraqitjeve publike kishte mbështetur organizatën terroriste të Fetullah Gylenit. Alpay argumentoi se privimi i tij nga liria ishte hakmarrje për qëndrimet e tij kritike ndaj qeverisë.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi **shkelje të nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës**. Gjykata vlerësoi se autoritetet turke nuk kishin bazë të arsyeshme për ta privuar nga liria dhe se shkrimet e tij përfaqësonin shprehje të mendimit politik, e jo thirrje për dhunë. Paraburgimi ishte një masë joproporcionale dhe krijonte një “efekt ftohës” (chilling effect) mbi gazetarët dhe publikun e gjerë.

Rasti *Şahin Alpay kundër Turqisë* është një **shembull tipik i SLAPP-it institucional**, ku shteti përdor sistemin ligjor për të heshtur mendimin kritik. GJEDNJ konstatoi qartë se masa të tilla janë joproporcionale dhe të dëmshme për një shoqëri demokratike. Me këtë vendim, Gjykata konfirmoi se procedurat penale ose juridike të motivuara politikisht përbëjnë kërcënim për lirinë e shprehjes dhe në mënyrë thelbësore minojnë diskursin demokratik.

Elementet SLAPP në rast

Elementi	Përshkrimi
Qëllimi i padisë	Heshtja e një gazetari kritik përmes nisjes së një procedure penale
Presion institucional	Shteti përdor sistemin gjyqësor për represion dhe për të heshtur mendimin kritik
Mungesë e provave konkrete	Vetëm tekstet gazetareske janë përdorur si bazë, pa prova konkrete
Efekt frikësues	Paraburgimi dërgon një mesazh paralajmërues për gazetarë dhe intelektualë të tjerë
Sfond politik	I lidhur me përpjekjen për grusht shteti dhe gjendjen e jashtëzakonshme në Turqi

⁶ Shih [https://hudoc.echr.coe.int/fre#%22itemid%22:\[%22001-181866%22\]](https://hudoc.echr.coe.int/fre#%22itemid%22:[%22001-181866%22])

3. ANALIZË KRAHASUESE



1. BELGJIKA

1. Rregullore formale anti-SLAPP

Në Belgjikë, ashtu si në të gjitha vendet anëtare të BE-së, nuk ekziston një ligj zyrtarisht i miratuar anti-SLAPP. Megjithatë, Belgjika është një nga vendet e para anëtare të BE-së ku është përgatitur një projektligj model, i cili përfaqëson një bazë të fortë dhe një nismë të qeverisë dhe parlamentit për transpozimin e Direktivës (BE) 2024/1069. Projektligji model tregon se si rregullorja kombëtare mund ta zbatojë Direktivën e BE-së dhe të shtojë garanci shtesë (procedura penale, përfshirje jashtë territorit, detyrim institucional). Kjo mund të shërbejë si model për vendet që synojnë një nivel më ambicioz mbrojtjeje. Projektligji përmban shumë nga mekanizmat kryesorë të parashikuar në vetë Direktivën: refuzim i hershëm i padive qartësisht të pabazuara, detyrim për paditësin të mbulojë shpenzimet gjyqësore dhe tarifat e avokatëve, sanksione; gjithashtu parashikohet dëmshpërblim dhe mundësi për ndihmë juridike.

2. Harmonizimi me Direktivën e BE-së dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës

Projektligji model paraqet një hap përpara dhe një avancim të Direktivës së BE-së për arsyet e mëposhtme:

- **Fusha e veprimit:** përfshirja e procedurave penale – Direktivën mbulon kryesisht procedurat civile dhe tregtare me element ndërkufitar; projektligji belg përfshin mekanizma të ngjashëm mbrojtës edhe në procesin penal. Kjo është një zgjerim thelbësor i fushës së mbrojtjes.
- **Mbrojtje jashtëterritoriale (vendet e treta):** projektligji përfshin rregulla për njohjen/ekzekutimin dhe për juridiksionin lidhur me vendimet dhe procedurat e nisura në vende të treta, duke ofruar mbrojtje kur sulmet vijnë nga jashtë BE-së. Direktiva fokusohet në çështjet ndërkufitare, por nuk parashikon mekanizma aq të qartë për vendet e treta.

- **Sanksione dhe shpenzime:** Direktiva lejon mundësinë e rimbursimit të shpenzimeve dhe kompensimit të dëmit, duke ia lënë shteteve vendimin për sanksionet. Në Belgjikë, gjykata mund të vendosë gjoba deri në 25.000 €, kompensim të plotë dhe madje dëmshpërblim ndëshkues.
- **Afate dhe procedura të detajuara:** projektligji përcakton afate të qarta (p.sh. – 30 ditë për vendim mbi refuzimin e hershëm), përfshin mundësi për gjykatën të veprojë ex officio dhe integron procedura të shkurtra për ankesat dhe pasojat. Direktiva vendos kornizën, por nuk është aq e detajuar.
- **Mbështetje për viktimat (paketë e gjerë):** projektligji përcakton konkretisht detyrat e institucionit për të drejtat e njeriut – përfshirë mbështetje ligjore, financiare, psikologjike dhe teknike – dhe parashikon llogaridhënie. Rekomandimi i Këshillit të Evropës insiston në masa të tilla, por propozimi belg i shndërron ato në detyrim ligjor.

Në raport me **Rekomandimin e Këshillit të Evropës**, projektligji përfshin shumicën e rekomandimeve për SLAPP, si për shembull: përfshirjen e gjerë të “pjesëmarrjes publike”, treguesit për identifikim, kompensimin, sanksionet, ndihmën ligjore, trajnimet dhe ngritjen e vetëdijes.

3. Masa institucionale

Në Belgjikë është vendosur një mekanizëm institucional funksional për ndjekjen dhe adresimin e rasteve SLAPP. **Instituti Federal për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut (FIRM-IFDH)** është caktuar nga qeveria federale si pika qendrore e kontaktit për këtë çështje⁷. Instituti vepron si organ koordinues dhe bartës i aktiviteteve për monitorim, këshillim dhe mbështetje të palëve të prekura. Paralelisht, aktive është edhe Grupi i Punës Anti-SLAPP, i përbërë nga gazetarë, organizata qytetare, juristë dhe akademikë, i cili ka një rol të rëndësishëm në përgatitjen e propozim-ligjeve, konsultimet publike dhe procesin e hartimit të politikave në këtë fushë.

Në pjesën e **mbështetjes financiare dhe administrative**, ende nuk ekzistojnë fonde apo programe shtetërore të veçanta që sigurojnë ndihmë juridike ose financiare të drejtpërdrejtë për viktimat e rasteve SLAPP. Megjithatë, projekt-ligji model parashikon mundësinë që i padituri të kërkojë kompensim dëmi, përfshirë shpenzimet gjyqësore, gjë që përfaqëson një formë të mbrojtjes financiare.

Në fushën e **edukimit, ndërgjegjësimit publik dhe mbledhjes së të dhënave**, Grupi i Punës dhe FIRM-IFDH organizojnë në mënyrë aktive prezantime publike, fushata dhe konsultime, si dhe aktivitete për dokumentimin e rasteve.

4. Praktika gjyqësore dhe statistika

Meqenëse legjislacioni anti-SLAPP në Belgjikë ende nuk është miratuar, nuk ekziston praktikë gjyqësore e konsoliduar që i referohet qartë dispozitave të tilla ligjore. Megjithatë, ka disa raste gjyqësore që përmbajnë karakteristika të SLAPP-it dhe trajtohen si të tilla në diskursin publik dhe profesional. Në këto raste, gjykatat shpesh i hedhin poshtë paditë ose i lirojnë të paditurit për mungesë baze ligjore, duke njohur synimin e paditësve për të ushtruar presion ose frikësim ndaj gazetarëve dhe organizatave.

Një shembull tipik është rasti **Apache kundër Land Invest Group**⁸, ku portali hulumtues Apache u përball me një sërë padish nga investitori ndërtimor Land Invest Group dhe përfaqësuesi i tij Erik Van der Paal. Të gjitha paditë u hodhën poshtë, por proceset rezultuan me shpenzime të konsiderueshme financiare për gazetarët, gjë që ilustron efektin frikësues dhe heshtës tipik për rastet SLAPP. Një rezultat i ngjashëm pati edhe në rastin **Leuven**

⁷ Shih https://globalfreedomofexpression.columbia.edu/publications/belgium-a-model-for-the-transposition-of-the-eu-anti-slapp-directive/?utm_source=chatgpt.com

⁸ Shih më shumë në <https://merlin.obs.coe.int/article/9594>

Historical Society kundër Resiterra⁹, në të cilin kompania ndërtimore kërkoi dëmshpërblim prej 100.000 eurosh nga anëtarët e shoqatës, duke pretenduar se aktivitetet e tyre kishin shkaktuar vonesa në projekt. Edhe pse rasti nuk përfundoi me një vendim gjyqësor si në rastin Apache, përpjekja për të kërkuar një dëmshpërblim të lartë për shkak të veprimtarisë ligjore të një shoqate është tipike për paditë SLAPP. Ky është një shembull i keqpërdorimit të ligjit për të heshtur kritikën publike, veçanërisht kur bëhet fjalë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Këto shembuj tregojnë se gjyqësori belg, edhe në mungesë të një ligji të posaçëm, në praktikë i njuh dhe i refuzon procedurat me karakter SLAPP.

Aktualisht **nuk ekziston një regjistër kombëtar** apo statistikë zyrtare për rastet SLAPP. Grupi i Punës Anti-SLAPP Belgium dhe FIRM-IFDH dokumentojnë dhe publikojnë shembuj, por të dhënat nuk janë të sistematizuara dhe nuk ka raport publik që të tregojë sa raste formalisht janë klasifikuar si SLAPP.

5. Iniciativat dhe roli i sektorit qytetar

Sektori qytetar në Belgjikë luan një rol kyç në zhvillimin e kornizës anti-SLAPP dhe në ngritjen e ndërgjegjësimit për keqpërdorimin e procedurave gjyqësore kundër gazetarëve, aktivistëve dhe studiuesve. Rol qendror ka Grupi i Punës Anti-SLAPP Belgjikë, një koalicion i gjerë i përbërë nga media, organizata joqeveritare, akademikë dhe juristë. Ky grup pune koordinon në mënyrë aktive propozime dhe iniciativa, ndjek raste individuale dhe merr pjesë në konsultime publike të lidhura me hartimin e legjislacionit kombëtar anti-SLAPP.

Grupi belg i punës është pjesë e rrjeteve dhe koalicioneve më të gjera që lidhin aktorët lokalë me nismat evropiane, si **CASE (Coalition Against SLAPPs in Europe)**¹⁰, Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. Këto partneritete mundësojnë shkëmbim praktikash, njohurish dhe një qasje të përbashkët në mbrojtjen e politikave anti-SLAPP në nivel evropian.

Aktivitetet e sektorit joqeveritar janë të orientuara drejt **avokimit publik dhe mbështetjes së proceseve gjyqësore (advocacy and litigation support)**. Organizata dhe media si Apache¹¹ dhe iniciativa Samen Sterk! zhvillojnë rregullisht fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe dokumentimin e rasteve konkrete me karakter SLAPP, me qëllim që të theksojnë nevojën për mbrojtje ligjore efektive.

6. Përfundim

Model-ligji belg nuk është vetëm transpozim i Direktivës së BE-së, por edhe një **përmirësim i saj**:

- e zgjeron fushën e zbatimit në raste të brendshme dhe penale,
- vendos refuzim të përshpejtuar me afate konkrete,
- parashikon sanksione dhe kompensime të larta,
- shton klauzola mbrojtëse ndërkombëtare,
- dhe vendos një kornizë institucionale (FIRM/IFDH).

Në thelb, Belgjika aktualisht po ecën drejt modelit më të fuqishëm të mundshëm për luftën kundër SLAPP në Evropë.

⁹ Shih <https://www.robtv.be/nieuws/resiterra-vraagt-minstens-100000-euro-van-leuvens-historisch-genootschap-omdat-het-teveel-juridische-procedures-zou-hebben-ingesteld-115658/>

¹⁰ Shih <https://slapp-monitor.eu/country/belgium/>

¹¹ Apache është një medium që merret me gazetari hulumtuese kritike dhe është një objektiv i drejtpërdrejtë i padive SLAPP.



2. IRLANDA

1. Rregullore formale anti-SLAPP

Irlanda nuk ka ende një ligj të plotë dhe të veçantë që të mbulojë të gjitha format e SLAPP. Megjithatë, aktualisht po punohet për ndryshimin e Ligjit për Shpifje (Defamation Act) përmes “Defamation (Amendment) Bill 2024”, i cili përfshin dispozita anti-SLAPP. Ky projektligj përqendrohet kryesisht në rastet e shpifjes. Masat anti-SLAPP të propozuara zbatohen vetëm brenda fushës së shpifjes, dhe jo për baza të tjera ligjore si privatësia, të drejtat e autorit, mbrojtja e të dhënave e të ngjashme¹². Disa nga masat e propozuara janë: mundësia për “refuzim të hershëm” të padive për shpifje nëse është e qartë se bëhet fjalë për SLAPP, deklarata gjyqësore që padia është SLAPP, procedura të përshpejtuara për trajtimin e këtyre rasteve dhe mundësia që gjykata të akordojë dëmshpërblim (kompensim) për personat që janë objekt i procedurave SLAPP.

2. Harmonizimi me Direktivën e BE-së dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës¹³

Irlanda ende nuk e ka transpozuar Direktivën e BE-së, ndërsa afati për të gjitha vendet anëtare është 7 maj 2026. Projektligji “Defamation (Amendment) Bill 2024” përfshin disa nga elementet e Direktivës, veçanërisht në fushën e shpifjes, refuzimit të hershëm (early dismissal), dhe trajtimin të detyrueshëm të padive SLAPP. Megjithatë, sipas organizatave civile dhe ekspertëve, projektligji nuk i përfshin të gjitha standardet dhe mbrojtjet minimale që përcakton Direktiva, si për shembull: palët e treta që mbështesin të paditurin, garancitë për kompensimin e dëmit, zhvendosjen e barrës së provës, mbrojtjen nga paditë SLAPP nga vende të treta etj.

Aktualisht, Irlanda ka një nivel të kufizuar të harmonizimit me Rekomandimet e Këshillit të Evropës CM/Rec(2024)2 për luftën kundër padive SLAPP: nuk ekziston pikë kontakti apo institucion shtetëror i dedikuar për SLAPP, mungojnë fondet, programet ose detyrimet për ndihmë, nuk zhvillohen trajnime apo fushata ndërgjegjësimi, nuk ka regjistër publik apo raport për rastet SLAPP dhe nuk janë përfshirë mekanizma jashtë-territoriale.

¹² Shih <https://www.irishlegal.com/articles/irish-bill-on-slapps-will-be-impotent-in-practice?utm>

¹³ Shih <https://rm.coe.int/0900001680af2805>

3. Masa institucionale

Irlanda **nuk ka një institucion të caktuar** si pikë kontakti për rastet SLAPP, ndryshe nga Belgjika, ku FIRM-IFDH e ka atë rol. Nuk ekziston asnjë agjenci shtetërore që ndjek, analizon ose reagon në mënyrë sistematike ndaj padive SLAPP. **Ireland Anti-SLAPP Network**, një koalicion joformal i përbërë nga juristë, gazetarë dhe OJQ, është i vetmi mekanizëm aktiv i monitorimit, por pa status zyrtar apo mbështetje shtetërore.

Në Irlandë nuk ekzistojnë fonde apo programe shtetërore për ndihmë juridike ose financiare të drejtpërdrejtë për viktimat e SLAPP, dhe nuk ka detyrim ligjor për kompensim të shpenzimeve, përveç rasteve të vendimeve gjyqësore për shpifje. Organizatat civile ndonjëherë organizojnë fushata crowdfunding për të mbështetur gazetarë ose aktivistë të paditur, por kjo nuk është e institucionalizuar.

Për më tepër, Irlanda nuk zbaton programe shtetërore për trajnim ose ndërgjegjësim publik për SLAPP, dhe nuk ka regjistër kombëtar apo bazë të dhënash për rastet SLAPP.

4. Praktika gjyqësore dhe statistika

Edhe pse Irlanda nuk ka një regjistër zyrtar të rasteve SLAPP, praktika tregon ekzistencën e padive me karakter SLAPP, veçanërisht nga subjekte politike kundër mediave. Shembulli më i njohur është rasti i partisë politike Sinn Féin dhe paditë e saj kundër The Irish Times dhe gazetarit Harry McGee, si dhe ndaj RTÉ – servisit publik radioteleviziv – dhe autorëve e botuesve të tjerë të librave. Sipas organizatës ARTICLE 19, këto padi kanë karakteristika të qarta të SLAPP, pasi janë të drejtuara ndaj gazetarëve individualë, përsëriten dhe kanë efekt frikësues e heshtës ndaj kritikës publike¹⁴.

5. Iniciativat dhe roli i sektorit qytetar

Sektori qytetar në Irlandë, i udhëhequr nga “Ireland Anti-SLAPP Network”, luan një rol kyç në monitorimin, avokimin dhe propozimin e ndryshimeve në legjislacionin anti-SLAPP. Bëhet fjalë për një koalicion organizatash qytetare, avokatësh dhe mediash, i cili kryen monitorim, jep rekomandime dhe propozon ndryshime në ligj. Përveç kësaj, në Irlandë veprojnë **rreth 30 organizata**¹⁵ të cilat mbështetën deklaratën e përbashkët për forcimin e legjislacionit anti-SLAPP, ndër të cilat: RTÉ – shërbimi publik radiodifuziv, NUJ (National Union of Journalists) – sindikata e gazetarëve, ICCL (Irish Council for Civil Liberties), si dhe organizata të tjera të njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe lirinë e medias, si ARTICLE 19 dhe Committee to Protect Journalists (CPJ). Këto grupe janë aktive në konsultime publike, avokim para parlamentit dhe në mobilizimin e opinionit publik për mbështetjen e gazetarëve, aktivistëve dhe akademikëve.

6. Përfundim

Irlanda ka një **kornizë ligjore fillestare**, por ajo është e **kufizuar dhe e pamjaftueshme** sipas standardeve evropiane. Ndryshe nga Belgjika, **nuk ekziston një strukturë institucionale, nuk janë përfshirë mekanizmat kyçe të Direktivës**, dhe **sektori qytetar është forca kryesore që shtyn ndryshimet**. Irlanda duhet të intensifikojë përpjekjet e saj deri në maj 2026 për të shmangur shkeljen e detyrimeve ndaj BE-së dhe për të siguruar mbrojtje efektive nga paditë SLAPP.

¹⁴ Shih më shumë në <https://www.article19.org/resources/ireland-sinn-feins-legal-actions-against-media-bear-hallmarks-of-slapps/>

¹⁵ Shih <https://www.irishlegal.com/articles/irish-bill-on-slapps-will-be-impotent-in-practice>



3. GREQIA

1. Rregullore formale anti-SLAPP

Greçia ende nuk ka miratuar një ligj të veçantë anti-SLAPP ose dispozita të tjera ligjore që integrojnë mekanizmat mbrojtës të parashikuar nga Direktiva (BE) 2024/1069. Edhe pse Direktiva hyri në fuqi në maj 2024, procesi i transpozimit nuk ka filluar, që do të thotë se gazetarët, organizatat qytetare dhe aktivistët mbeten pa mbrojtje të formalizuar nga procedurat gjyqësore abuzive.

Aktualisht, ekzistojnë vetëm dispozita të përgjithshme në Kodin Civil dhe në Ligjin për Mediat, të cilat ofrojnë mbrojtje të kufizuar përmes parimit të “keqpërdorimit të të drejtës”, por këto nuk janë të mjaftueshme për të parandaluar paditë SLAPP ose për të siguruar kompensim për viktimat.

2. Harmonizimi me Direktivën e BE-së dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës

Në aspektin e harmonizimit, Greçia aktualisht **ndodhet në fazën fillestare të zbatimit**.

Me Direktivën (BE) 2024/1069:

Greçia deri më tani nuk i ka futur mekanizmat kyç të Direktivës, si:

- refuzimi i hershëm i padive të pabazuara;
- kompensimi i viktimave të procedurave SLAPP;
- sanksionet procedurale për paditësit që keqpërdorin procesin gjyqësor;
- mundësia e zbatimit ndërkufitar të masave mbrojtëse.

Në Ministrinë e Drejtësisë është në zhvillim një analizë ligjore për mundësitë e përfshirjes së këtyre masave përmes ndryshimeve në Ligjin për Procedurën Civile.

Me Rekomandimin CM/Rec(2024)2 të Këshillit të Evropës:

Edhe pse në praktikë ekzistojnë aktivitete që ndjekin udhëzimet e Rekomandimit (si edukimi, monitorimi i rasteve, konsultimet dhe mbështetja publike për viktimat), nuk ekziston një mekanizëm formal për zbatimin e masave mbrojtëse të parashikuara nga Këshilli i Evropës. Nuk ka fonde për ndihmë juridike, sistem trajnimi gjyqësor për SLAPP, apo protokolle bashkëpunimi midis gjykatave dhe organizatave të gazetareve.

3. Masa institucionale

Ministria e Drejtësisë ka formuar një komision pune me qëllim shqyrtimin e modeleve të mundshme për transpozimin e Direktivës së BE-së dhe vlerësimin e kuadrit ligjor ekzistues. Për më tepër, është krijuar **SLAPP Observatory** nën mbikëqyrjen e Ministrisë, me mandat për të mbledhur të dhëna, për të komunikuar me palët e interesuara dhe për të dhënë rekomandime për ligjin e ardhshëm. Brenda **Task Forcës për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gazetarëve**, e krijuar sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, zhvillohet një dialog i vazhdueshëm midis institucioneve shtetërore, shoqatave të mediave dhe sektorit qytetar për zhvillimin e politikave kombëtare në luftën kundër rasteve SLAPP.

4. Praktika gjyqësore dhe statistika

Meqenëse nuk ka një kornizë të veçantë anti-SLAPP, gjykatat greke nuk zbatojnë procedura të veçanta për refuzimin e hershëm të padive apo për sanksionimin e keqpërdorimit të procedurave gjyqësore. Megjithatë, në disa raste, gjykatat kanë hedhur poshtë paditë kundër gazetarëve ose aktivistëve, duke arsyetuar se qëndrimet e shprehura janë pjesë e debatit publik dhe nuk përmbajnë elemente shpifjeje. Mungon një statistikë e sistematizuar. Të dhënat për rastet SLAPP mblidhen kryesisht nga OJQ-të si POESY dhe GovWatch, të cilat tregojnë një rritje të numrit të rasteve vitet e fundit, veçanërisht kundër gazetarëve hulumtues dhe mediave lokale.

5. Iniciativat dhe roli i sektorit qytetar

Sektori qytetar luan një rol kyç në monitorimin, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe avokimin për ndryshime ligjore. Organizatat **Hellenic League for Human Rights, Reporters United, GovWatch, VouliWatch** dhe të tjera janë aktive në dokumentimin e rasteve SLAPP dhe në kërkimin e masave sistematike mbrojtëse.

Përveç kësaj, sindikatat e gazetarëve (veçanërisht POESY) drejtojnë një SLAPP Observatory për ndjekjen e trendeve dhe raportimin publik të rasteve. Akademikët dhe ekspertët, si dhe profesionistët e mediave, marrin pjesë rregullisht në konsultime publike dhe përgatisin analiza për modelet e mundshme të transpozimit të standardeve evropiane.

6. Përfundim

Greqia ndodhet në fazën përgatitore, me një sektor qytetar aktiv dhe iniciativa institucionale që krijojnë një bazë të mirë për transpozimin e ardhshëm të Direktivës së BE-së. Megjithatë, vendi **mbetet pa mekanizma ligjorë thelbësorë** për parandalimin e procedurave abuzive dhe për mbrojtjen e lirisë së shprehjes.

Në fazën e ardhshme, prioritet duhet të jetë:

- miratimi formal i një ligji që do të transpozojë Direktivën;
- futja e mbrojtjeve efektive gjyqësore dhe procedurale;
- krijimi i një fondi për mbështetje ligjore të viktimave;
- monitorimi sistematik dhe raportimi publik për rastet SLAPP.



4. SERBIA

1. Rregullore formale anti-SLAPP

Serbia **nuk ka** një ligj të veçantë, të zhvilluar plotësisht dhe formal anti-SLAPP. Kornizat ekzistuese ligjore (p.sh. të drejtën penale dhe civile, ligjet për shpifje etj.) nuk ofrojnë mekanizma të specializuar dhe sistematikë për mbrojtje të shpejtë nga paditë strategjike dhe keqdashëse kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP). Si rezultat, paditë individuale kundër gazetarëve, mediave dhe aktivistëve trajtohen sipas normave dhe rregullave të përgjithshme ligjore, gjë që krijon hapësirë për procese të gjata dhe të kushtueshme me efekt frikësues.

2. Harmonizimi me Direktivën e BE-së dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës

Me Direktivën (BE) 2024/1069: Serbia nuk është anëtare e BE-së dhe formalisht nuk është e detyruar ta transpozojë Direktivën. Megjithatë, si vend kandidat, ekziston presion dhe pritshmëri politike dhe praktike për ta përafuar praktikën me standardet evropiane brenda procesit të zgjerimit. Raportet e monitorimit për negociatat e anëtarësimit theksojnë nevojën për përmirësimin e lirisë së mediave dhe mbrojtjen e interesit publik, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga paditë abuzive¹⁶.

Me Rekomandimin CM/Rec(2024)2 të Këshillit të Evropës: Këshilli i Evropës ka miratuar rekomandimin për trajtimin e rasteve SLAPP dhe po zhvillon aktivitete mbështetëse (trajnimet, udhëzimet) të drejtuara ndaj gjyqësorit dhe institucioneve kombëtare. Në Serbi po zhvillohen trajnime dhe diskutime mbi zbatueshmërinë e rekomandimit, por nuk mund të konstatohet një adoptim i plotë sistematik i të gjitha masave dhe mekanizmave të propozuar nga Këshilli (p.sh. pikë kombëtare kontakti, fond për ndihmë ligjore për viktimat, monitorim sistematik apo raporte për rastet SLAPP etj.).

3. Masa institucionale

Në Serbi nuk ekziston një pikë kontakti shtetërore e përcaktuar qartë apo një agjenci e specializuar me mandat për të ndjekur, koordinuar dhe reaguar ndaj padive SLAPP në nivel kombëtar. Monitorimi dhe analizat

¹⁶ Shih https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/3c8c2d7f-bff7-44eb-b868-414730cc5902_en?filename=Serbia+Report+2024.pdf&utm

kryesisht vijnë nga organizata të pavarura dhe koalicione rajonale. Këshilli i Evropës dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë organizojnë trajnime dhe seminare për gjyqtarë, avokatë dhe shoqërinë civile në Serbi, me qëllim njohjen e institucioneve me CM/Rec(2024)2 dhe praktikën e mira për identifikimin e hershëm të padive SLAPP¹⁷. Këto aktivitete janë pozitive, por nuk e zëvendësojnë nevojën për një zgjidhje ligjore sistemike dhe një politikë kombëtare. Në Serbi nuk ka një fond shtetëror të institucionalizuar për ndihmë ligjore të dedikuar posaçërisht për viktimat e SLAPP; iniciativat e avokatëve/OJQ-ve dhe crowdfunding shpesh përdoren për të mbështetur gazetarët dhe aktivistët e paditur.

4. Praktika gjyqësore dhe statistika

Ekzistojnë disa raste të SLAPP në Serbi. Në rastin kundër portalit hulamtues KRIK¹⁸ Paditësja ishte gjykatësja Dushanka, anëtare e trupit gjykues që kishte liruuar të akuzuarit për vrasjen e gazetarit Slavko Ćuruvija. Gazetarët Stevan Dojčinović dhe Bojana Pavlović nga KRIK kishin publikuar një listë të pasurisë së gjykatëses duke përdorur të dhëna publikisht të disponueshme. Gjykatësja kërkoi dënim me burg dhe ndalim të punës për gazetarët për një periudhë prej dy vitesh. Kjo padi është vlerësuar si SLAPP nga CASE dhe International Federation of Journalists, pasi ka për qëllim frikësimin dhe heshtjen e gazetarisë hulamtuese. Fondacioni Slavko Ćuruvija gjithashtu është përballur me padi nga ish-pjesëtarë të sigurimit shtetëror, të cilët kërkonin dëmshpërblim për shpifje të supozuar në lidhje me proceset gjyqësore. Ky rast është njohur nga organizatat ndërkombëtare **CASE** dhe **ARTICLE 19** si përpjekje për frikësim dhe heshtje të debatit publik kritik, duke e kualifikuar atë si një rast tipik SLAPP.

5. Iniciativat dhe roli i sektorit qytetar

Në Serbi, sektori qytetar luan një rol qendror në rezistencën ndaj padive SLAPP, i udhëhequr nga Grupi Kombëtar i Punës për Luftën kundër SLAPP, i cili bashkon NUNS ((Nezavisno udruženje novinara Srbije), Fondacionin Slavko Ćuruvija, Građanske Inicijative dhe organizata të tjera¹⁹. Ky koalicion zhvillon në mënyrë aktive monitorimin e rasteve, organizon fushata dhe protesta publike, përgatit raporte dhe analiza juridike – ndër të cilat spikat raporti rajonal “From Silence to Strength” – dhe krijon bashkëpunim ndërkombëtar me rrjete si CASE dhe IFJ, me qëllim forcimin e rezistencës dhe sigurimin e mbrojtjes sistemike për gazetarët dhe aktivistët²⁰. Në Serbi funksionon një regjistër për rastet SLAPP: <https://slapp.rs/>. Ky regjistër, që është i vetmi i këtij lloji në Evropë, mundëson ndjekjen sistematike të trendeve dhe rritjen e dukshmërisë së problemit me paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike, duke kontribuar gjithashtu në përmbytjen e rekomandimeve të Këshillit të Evropës në pjesën që lidhet me nevojën për krijimin e regjistrave të tillë.

6. Përfundim

Serbia përballlet me një problem serioz me paditë SLAPP, veçanërisht kundër mediave të pavarura dhe gazetarëve. **Nuk ekziston kornizë ligjore, mbrojtje institucionale apo reagim shtetëror**, ndërsa sektori qytetar mbetet i vetmi aktor aktiv. Për të siguruar mbrojtje efektive, janë të domosdoshme **reforma ligjore, caktimi i institucioneve kompetente, krijimi i fondeve mbështetëse dhe harmonizimi me standardet evropiane**.

¹⁷ Shih <https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/-/council-of-europe-rolls-out-anti-slapp-training-for-judges-and-civil-society-in-serbia?utm>

¹⁸ Shih <https://balkaninsight.com/2024/07/17/surge-in-slapps-hits-serbias-independent-media-hard/>

¹⁹ Shih <https://balkaninsight.com/2024/07/17/surge-in-slapps-hits-serbias-independent-media-hard/>

²⁰ Shih https://www.gradjanske.org/wp-content/uploads/2024/08/From-Silence-to-Strength_-_A-Regional-Response-to-SLAPPs-in-the-Western-Balkans-Country-report-for-Serbia.pdf



5. MALI I ZI

1. Rregullore formale anti-SLAPP

Mali i Zi aktualisht **nuk ka miratuar një rregullore të veçantë anti-SLAPP** dhe as mekanizma ligjorë që drejtpërdrejt njohin ose sanksionojnë keqpërdorimin e procedurave gjyqësore kundër gazetarëve, aktivistëve ose organizatave. Ekziston vetëm mbrojtje e pjesshme përmes Ligjit për Mediat (2020) dhe Ligjit për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje (2011)²¹, ku janë parashikuar disa kufizime në shumën e kompensimit për shpifje dhe fyerje. Megjithatë, këto ligje nuk përfshijnë mekanizma për refuzim të hershëm të padive SLAPP, as nuk i mundësojnë gjykatës t'i identifikojë zyrtarisht raste të tilla. Megjithatë, vitet e fundit është bërë një hap përpara me **dekriminalizimin e shpifjes**, çka e zvogëlon mundësinë e procedurave penale kundër gazetarëve. Pavarësisht kësaj, paditë civile për fyerje dhe dëmtim të imazhit mbeten një mjet i shpeshtë presioni ndaj mediave.

2. Harmonizimi me Direktivën e BE-së dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës

Mali i Zi, si vend kandidat për BE, nuk është formalisht i detyruar ta transpozojë Direktivën (BE) 2024/1069, por ndodhet nën presion politik për të harmonizuar praktikën e tij. Sipas **Vlerësimit Rajonal të Këshillit të Evropës**, Mali i Zi ka mekanizma bazë procedurale për refuzimin e padive të pabazuara, por **nuk ka përkufizim për SLAPP**, as një qasje sistemike për identifikimin e tyre. Rekomandimet CM/Rec(2024)2 nuk janë zbatuar plotësisht — nuk ka pikë kontakti, fonde apo detyrime për mbështetje institucionale.

3. Masa institucionale

Në Mal të Zi nuk ekziston një institucion shtetëror i caktuar me mandat për ndjekjen dhe reagimin ndaj padive SLAPP. Këshilli i Evropës organizon trajnime për gjyqtarë dhe juristë, veçanërisht përmes programit “Horizontal Facility”, por këto aktivitete kufizohen në ngritjen e kapaciteteve dhe nuk përbëjnë një politikë

²¹ Sipas analizës “SLAPP – Mechanism for silencing the public” (2023), të realizuar nga Montenegro Media Institute dhe partnerë të tjerë, këto ligje nuk janë të mjaftueshme për t'u përballur me SLAPP, dhe sistemi juridik në Mal të Zi ende nuk e njeh zyrtarisht këtë fenomen.

sistemike. Nuk ka fond shtetëror për ndihmë ligjore për viktimat e SLAPP, ndërsa mbështetja vjen kryesisht nga OJQ-të dhe donatorët ndërkombëtarë.

4. Praktika gjyqësore dhe statistika

Paditë kundër mediave Vijesti, CDM, Monitor dhe Dan, të ngritura nga funksionarë publikë dhe biznesmenë, kanë karakteristika tipike për SLAPP: ato janë të drejtuara kundër gazetarëve dhe redaksive që raportojnë për çështje me interes publik, kërkojnë kompensime joproporcionale të larta dhe kanë efekt frikësues dhe të vetëcensurës. Sipas Human Rights Action – HRA, këto padi shpesh nuk kanë bazë të vërtetë ligjore, por përdoren si mjet presioni dhe pengese ndaj raportimit kritik²².

5. Iniciativat dhe roli i sektorit qytetar

Sektori qytetar luan një rol kyç në monitorimin dhe avokimin e çështjes së SLAPP. Organizatat Human Rights Action, Trade Union of Media of Montenegro (SMCG) dhe Center for Investigative Journalism (CIN-CG) marrin pjesë aktive në fushata për mbrojtjen e gazetarëve dhe promovimin e ndryshimeve ligjore.

Në vitin 2023, këto organizata nisën një nismë të përbashkët për miratimin e një strategjie kombëtare anti-SLAPP, me rekomandime për futjen e një mekanizmi për refuzimin e hershëm të padive dhe për forcimin e edukimit gjyqësor. Në partneritet me organizata ndërkombëtare si ARTICLE 19 dhe European Centre for Press and Media Freedom (ECPMF), ato publikojnë rregullisht raporte dhe të dhëna mbi presionet ligjore ndaj mediave.

6. Përfundim

Mali i Zi ka shënuar përparim të kufizuar përmes reformave gjyqësore dhe dekriminalizimit të shpifjes, por ende nuk ka krijuar një ligj të veçantë anti-SLAPP, mbrojtje institucionale apo mekanizma sistemikë për identifikimin dhe parandalimin e hershëm të keqpërdorimit të procedurave gjyqësore. Sektori qytetar mbetet forca kryesore e rezistencës ndaj SLAPP-it, por për të siguruar mbrojtje efektive dhe harmonizim me standardet evropiane, janë të domosdoshme ndryshime ligjore, krijimi i një mekanizmi kombëtar koordinues dhe instrumente financiare për mbështetjen e viktimave.

²² Shih <https://www.hraction.org/?lang=en>



6. MAQEDONIA E VERIUT

1. Rregullore formale anti-SLAPP

Në Maqedoninë e Veriut aktualisht **nuk është miratuar një rregullore e veçantë anti-SLAPP**, as mekanizma ligjorë që në mënyrë eksplicite njohin ose sanksionojnë keqpërdorimin e procedurave gjyqësore kundër gazetarëve, aktivistëve dhe organizatave qytetare. Shpifja dhe fyerja u dekriminalizuan në vitin 2012, duke u hequr dispozitat penale nga Kodi Penal dhe duke u vendosur një model civil përmes Ligjit për Përgjegjësi Civile për Fyerje dhe Shpifje²³. Ky ligj parashikon: kufizim të shumës së kompensimit të dëmit; detyrimin e gjykatës që të marrë parasysh funksionin publik të paditësit dhe interesin publik; si dhe mundësinë e përjashtimit nga përgjegjësia nëse gazetari ka vepruar me mirëbesim.

2. Harmonizimi me Direktivën e BE-së dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës

Si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Maqedonia e Veriut nuk është formalisht e detyruar ta transpozojë Direktivën (BE) 2024/1069, por është politikisht e inkurajuar të harmonizojë legjislacionin e saj me të. Shkalla e harmonizimit të Maqedonisë së Veriut me Rekomandimin e Këshillit të Evropës CM/Rec(2024)2 për luftën kundër padive SLAPP është në fazën fillestare të zbatimit – aktualisht e fokusuar kryesisht në trajtime dhe ngritje të vetëdijes, ndërsa mbrojtja formale ligjore ende mungon.

3. Masa institucionale

Aktualisht nuk ekziston ndonjë institucion shtetëror i caktuar me mandat për të monitoruar dhe reaguar ndaj padive SLAPP. Si rrjedhojë, në Maqedoninë e Veriut mungon një mekanizëm shtetëror, fond mbështetës dhe një pikë kontakti formale për raste SLAPP. Për më tepër, nuk ekzistojnë mekanizma për refuzim të hershëm të padive me karakter SLAPP, dhe gjykatat nuk kanë mundësi formale për t'i identifikuar apo sanksionuar këto raste. Në praktikë, funksionarë publikë, politikanë dhe biznesmenë shpesh paraqesin padi për “fyerje të nderit dhe reputacionit” me kërkesa të larta dëmshpërblimi, gjë që shkakton efekt frikësues dhe vetëcensurë te mediat.

²³ Shih <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Primena-na-zakonot.pdf>

4. Praktika gjyqësore dhe statistika

Maqedonia e Veriut nuk ka një regjistër zyrtar apo statistika për rastet SLAPP, por hulumtimet e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) tregojnë një rritje të numrit të padive kundër gazetarëve dhe mediave. Sipas të dhënave të SHGM-së për katër vitet e fundit, vërehet një trend i qartë i përdorimit gjithnjë e më të shpeshtë të padive SLAPP si mjet për frikësim dhe presion ndaj gazetarisë hulumtuese. Në vitin 2021 janë evidentuar katër raste SLAPP ndaj gazetarëve nga media të ndryshme, të ngritura nga ish-funksionarë dhe përfaqësues të partive politike. Në vitin 2022 janë regjistruar pesë padi, të gjitha të drejuara kundër një mediumi që publikoi seri storish hulumtuese të lidhura me temat e shëndetësisë dhe biznesit; paditë ishin përfaqësues të kompanive vendase e të huaja, si dhe të një institucioni shëndetësor privat. Në vitin 2023 kanë vazhduar procedurat gjyqësore për paditë e paraqitura më herët, disa prej të cilave janë ndjekur me veprime prokuroriale dhe seanca gjyqësore. Ndërsa në vitin 2024 janë regjistruar tetë padi dhe kallëzime penale të reja SLAPP, të ngritura nga institucione, subjekte biznesi, bashkësi fetare dhe përfaqësues partish politike kundër gazetarëve, mediave dhe redaktorëve, për publikime të informacionit me interes publik²⁴. Analiza e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) e konfirmon këtë trend shqetësues: Maqedonia e Veriut është ndër 10 vendet evropiane me shkallën më të lartë të rasteve SLAPP (0,29 për 100.000 banorë). Si shembull, në vitin 2022 janë evidentuar dy herë më shumë padi për fyerje dhe shpifje (54 padi) krahasuar me vitin 2021 (20 padi)²⁵. Rastet më të theksuara dhe më shpesh të cituara të SLAPP në Maqedoninë e Veriut janë ato të drejuara kundër Laboratorit të Reporterëve Hulumtues (IRL) dhe gazetarëve të tij²⁶. Këto raste janë shembuj tipikë se si paditë SLAPP përdoren për të rraskapitur financiarisht dhe frikësuar mediat që raportojnë për çështje me interes publik. Ekzistojnë edhe raste të tjera që tregojnë karakteristika të SLAPP-it – padi me kërkesa joproporcionale për dëmshpërblim, të paraqitura me qëllim ushtrimi presioni dhe heshtjeje të kritikës²⁷. Gjykatat në përgjithësi zbatojnë një kornizë civile pa ndonjë filtër specifik për SLAPP, ndërsa kohëzgjatja e proceseve shpesh është disavjeçare, gjë që e rrit barrën psikologjike dhe financiare mbi të paditurit²⁸.

5. Iniciativa dhe roli i sektorit qytetar

Sektori qytetar luan një rol kyç në monitorimin dhe avokimin e çështjeve anti-SLAPP. SHGM punon aktivisht për mbrojtjen e gazetarëve që përballen me padi SLAPP përmes:

- **Ofrimit të ndihmës juridike falas** dhe monitorimit për anëtarët e saj që paditen për shkak të punës gazetareske.
- **Përfaqësimit të gazetarëve në gjykatë**, veçanërisht në rastet kur paditë kanë karakteristika SLAPP – kërkesa joproporcionale, frikësim, abuzim me institucionet.
- **Mbajtjes së një regjistri publik** të sulmeve dhe shkeljeve të të drejtave të punonjësve të mediave, me qëllim dokumentimin dhe analizimin e trendeve të presioneve.

²⁴ Shih https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2025/08/AJM_Indicator-Report-2024_MKD.pdf

²⁵ Shih https://mcms.mk/images/docs/2024/From_Silence_to_Strength_A_Regional_Response_to_SLAPPs_in_the_Western_Balkans_Country_Report_for_North_Macedonia.pdf

²⁶ Shembull. Angjushev kundër IRL-së

²⁷ Një rast i tillë është “Pajazhina”, në të cilin objekt hetimi dhe presioni ishin televizioni A1 dhe kompanitë e tjera të familjes Ramkovski. Një shembull tjetër është padia e partisë Levica kundër gazetarit Xhabir Deralla. Levica paraqiti padi për shpifje kundër Derallës për gjoja shpifje në dy kolumna të botuara në rubrikën “Rafal” në faqen e internetit www.civilmedia.mk.

²⁸ Në raportin e fundit të vitit 2024 të Departamentit të Shtetit të SHBA për Maqedoninë e Veriut theksohet se ekziston një numër në rritje i padive kundër gazetarëve dhe mediave: <https://www.state.gov/reports/2024-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia>

Në vitin 2023, SHGM promovoi publikimin “Si të arrihet një mbrojtje më efektive nga SLAPP-et”²⁹, udhëzuesi i parë i këtij lloji në Ballkanin Perëndimor. Qëllimi është të përcaktohet koncepti i SLAPP-it në kontekst lokal, të rritet ndërgjegjësimi dhe të ofrohen rekomandime për mbrojtje juridike dhe institucionale.

6. Përfundim

